



Komuna e Klinës
Kryetari i Komunës
01Nr. 112-15465 /2019
Klinë, dt.15/04/2019

Duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare, nr.28 me dt. 04.06.2008, dispozitat e nenit 9 të Rregullores së MF nr.07/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, si dhe dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, si dhe duke marrë parasysh Thirrjen për financim të OJQ-ve të datës 28.02.2019, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 15/04/2019, mori;

V E N D I M

Për formimin e komisionit të ankesave lidhur me vlerësimin e kërkesave për financim të OJQ-ve

- FORMOHËT**, komisioni i ankesave për shqyrtimin e ankesave eventuale ndaj vendimeve për mos kualifikim apo ndarje të mbështetjes financiare, sipas thirrjes publike për financim të OJQ-ve. Përbërja e komisionit është, si në vijim:
 - Dafina Baca;
 - Mujë Gashi;
 - Ahmet Berisha .
- Blerim Gashi, CAKTOHET**, anëtarë rezerve i cili në rast nevojë do të zëvendësojë anëtarin e rregullt të komisionit të ankesave i cili paraqet konfliktin e interesit.
- Anëtarët e komisionit si nga pika 1 e këtij vendimi do të merren me shqyrtimin e ankesave dhe vendosjen e tyre në përputhje me dispozitat ligjore pozitive.
- Komisioni punën e vetë e kryen në përputhje me dispozitat e Rregullores së MF nr.04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, si dhe akteve të tjera pozitive që perligjojnë këtë fushë.
- Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Anëtarët e komisionit;
- Zyra kryetarit;
- Zyra e informimit;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj